

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga “magnet votash” në rrezik elektoral, Trump sfidon sondazhet dhe kundërshtarët
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/nga-magnet-votash-ne-rrezik-elektoral-trump-sfidon-sondazhet-dhe-kundershta-i584963
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 13:01:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 14:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f78a2531119a19ff00d0f673b38247b99073158d673589b50d6236dc520d11f1
TEKSTI	6d48dddc5a34efadffd377d1e56c96d88518c5f915cbc1189cfc3d3052ae83d8
PAMJA	e20bfcc28a0be88e6bd48aeea3ed7e2056c099e9b6ee2f00b63106bf6084d5df9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bae31ace1df4778d2f60fb2f8b6f5772eb943162ef338eb921e20999f5932908
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bae31ace1df4778d2f60fb2f8b6f5772eb943162ef338eb921e20999f5932908>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e "Parlamenti të luajë rol të rëndësishëm në procesin e integritetit", zbulohen kërkesat e ambasadores së BE-sëPerplasjet vazhdojnë: Harry dhe Meghan kundërshtojnë letërn zyrtare të Mbretit Charl

Nga “magnet votash” në rrezik elektoral, Trump sfidon sondazhet dhe kundërshtarët

9 Shtator 2026, 16:10Bota TEMA



Nga “magnet votash” në rrezik elektoral, Trump sfidon sondazhet

Zakonisht, presidentët e Shteteve të Bashkuara, kur afrohen zgjedhjet afatmesme, kujdesen të theksojnë se emri i tyre nuk është në fletën e votimit për rinovimin e Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit, në mënyrë që, në rast të një humbjeje, të mund t’ua atribuojnë përgjegjësinë kandidatëve të tjerë të partisë.

Donald Trump për njëfarë kohe e “përkëdheli” këtë ide, por më pas tundimi për të sfiduar traditën ishte më i fortë. Kështu, jo vetëm që u ka kërkuar amerikanëve të bëjnë sikur edhe ai vetë është në garë, me bindjen se është një magnet për votat, por ka vendosur edhe ta stampojë emrin e tij në të gjithë procesin elektoral, duke ideuar një Konventë të pazakontë që nis sot në Dallas.

“Trumpapalooza” e kanë quajtur kritikët e tij, edhe brenda vetë Partisë Republikane, pra një festival i personalitetit të tij, për të mos thënë i kultit ndaj tij, i cili sipas Trump duhet të afrojë sërish me GOP-in votuesit e lodhur nga lufta, inflacioni dhe kaosi.

Është një zgjedhje e guximshme, përveçse e pazakontë, sepse pasi ka vendosur kaq shumë fytyrën e tij në këtë garë, do të jetë shumë e vështirë të tërhiqet më pas dhe t’ua kalojë të tjerëve përgjegjësinë për një dështim të frikshëm.

Ai, megjithatë, është i bindur se sondazhet, të cilat e nxjerrin popullaritetin e tij pak mbi 30 për qind, gënjejnë. Sipas tij, sapo t’u kujtojnë amerikanëve rezultatet e dy viteve të para të mandatit, referendumi mbi veten e tij do të shndërrohet në një triumf, në vend që të kthehet në një kurch.

Nuk duket se beson shumë në këtë skenar as zonja e parë, Melania Trump, e cila nuk do të jetë sonte në Dallas, kur bashkëshorti i saj do të mbajë fjalimin kryesor të Konventës.

Ndoshta është thjesht e bezdisur nga roli gjithnjë e më i madh i luajtur nga asistente Natalie Harp, por disa e shohin mungesën e saj si një shenjë mosbesimi, madje shumë pranë një “tradhtie” politike, e aftë të krijojë një boshllëk në skenë që mund të ketë peshë.

Nuk do të jetë aty as kandidatja për Senatin në Maine, Susan Collins, dhe kjo është një shenjë e pagabueshme politike. Në teori, ajo ka refuzuar pjesëmarrjen sepse kishte angazhime të tjera në fushatën elektorale, por në praktikë sepse druhet se të shfaqet në një skenë në Teksas së bashku me Trumpin nuk do ta ndihmojë aspak në zonat e pyllëzuara të New England-it, ku votuesit janë të irrituar nga rritja e çmimit të benzinës, madje më shumë sesa nga vetë lufta në Iran.

Konventa nis sot pasdite dhe që sonte presidenti do të mbajë fjalimin e tij, sepse mendon se në këtë mënyrë do të tërheqë vëmendjen maksimale. Ai do të qëndrojë edhe nesër, kur do t’i vijë radha zv.presidentit Vance të flasë, por Donald Trump do të mbajë gjithsesi fjalimin përmyllës.

Të gjithë figurat kryesore të administratës do të marrin pjesë, me synimin për të kujtuar ato që kreu i Shtëpisë së Bardhë i konsideron arritjet e tij të mëdha, nga emigracioni te tarifat doganore. Më pas do të jenë kandidatët nga distriktet dhe shtetet më të lëkundura, 35 sipas përllogaritjeve të Trumpit, të cilët shpresojnë të përfitojnë nga shkëlqimi i tij politik.

Një sfidë vendimtare do të jetë pikërisht ajo për vendin e senatorit të Teksasit, ku demokraci i ri Talarico po sfidon republikanin Paxton.

Nëse do të arrihte të fitonte, jo vetëm që do t’i hiqte GOP-it një vend kyç për të ruajtur shumicën në dhomën e lartë të Kongresit, por do të krijonte edhe përshtypjen e një shembjeje të republikanëve, e cila do të ishte e rrezikshme edhe në perspektivën e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2028.

Nuk mungojnë as mbështetësit e Trumpit që i druhen një efekti “boomerang”. Është e vërtetë se ai mbetet shumë popullor në bazën MAGA dhe shpesh ka përgënjeshtruar parashikimet më pesimiste të sondazheve, por rënia e popullaritetit të tij në rreth 30 për qind rrezikon ta tërheqë drejt fundit të gjithë partinë, në vend që ta ringrejë atë.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Merz: AFD mbështet politika sinonim të spastrimit etnik](#)

14:30 Bota

[Britani, rinisin fluturimet: Disa aeroporte ishin bllokuar pas defektit në kontrollin e trafikut](#)

14:10 Bota

[Përkallëzimi i luftës në Lindjen e Mesme rrit çmimin global të naftës](#)

13:50 Bota

[Liderja e AfD: Gjermania duhet të kufizojë pagesat ndaj BE-së, ne duam paratë tona mbrapsht](#)

13:40 Bota / 2 komente

[Zelensky ‘sinjalizon’ paqen: Jemi gati për kompromis](#)

12:35 Bota / 1 koment

[Trump përshëndet fitoren e AfD-së në Gjermani](#)

12:25 Bota / 2 komente

[Suedia paguan emigrantët për t’u larguar nga vendi](#)

12:05 Bota

[Studiuesi largohet nga Anthropic: Inteligjenca Artificiale mund të na shkatërrojë, po luajnë me jetën tonë](#)

11:55 Bota / 1 koment

[Telefonata njëorëshe Trump-Putin, Kremli: Bisedë konstruktive, Rusia nuk ka plane agresive ndaj Europës](#)

09:35 Bota / 2 komente

[Rubio paralajmëron Iranin: Sa herë të tentoni të godisni anijet amerikane, do të humbni cisterna](#)

09:25 Bota / 1 koment

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...](#)

14:15 Politika / 53 komente

[FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Beri...](#)

17:35 Politika / 110 komente

[Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...](#)

14:50 Politika / 10 komente

[Do blinte toka në Shqipëri, do investonte në Bogovë dhe u...](#)

22:50 Kronika / 4 komente

[Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...](#)

19:40 Politika / 118 komente

Blog Tema

[Pandeli Majko: Liria nuk gjykohet...](#)

13:00 Blog / 1 koment

[Një debat që nuk duhet të mbarojë te telefonat](#)

09:45 Blog / 3 komente

[25-vjetori i Marrëveshjes së Ohrit: Maqedoni, mars-gusht 2001](#)

09:15 Blog / 5 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, Tema është një nga gazetaret ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Drejtari](#)

— [Përshkrimi](#)

- [Turizëm](#)

- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

Built and Monetized by

— [Përshkrimi](#)

- [Hi-Tech](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.